



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ 2024

PËR

NJË NDRYSHIM DHE DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 298, DATË 20.04.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË TURIZMIT", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 12 , të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin" i ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 298, datë 20.04.2016, të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit" i ndryshuar, bëhet ndryshimi dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, togfjalëshi "*Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes*" zëvendësohet me "*Turizmit dhe Mjedisit*".

2. Në kreun I pas pikës 8.5, shtohen pikat 8.5/1 dhe 8.5/2, me përmbajtje si vijon:

"8.5/1 "Harton, në bashkëpunim me institucionet qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe grupet e interesit në fushën e turizmit, kalendarin turistik të aktiviteteve zbavitëse duke i orientuar ato për shtrirjet gjeografike si dhe për tematikën e eventeve të preferuara për turistët në këto zona duke koordinuar njëkohësisht edhe realizimin e këtij kalendari."

8.5/2 "Orienton, koordinon, dhe promovon kalendarin turistik si dhe monitoron ndjekshmërinë nga publiku e aktiviteteve të këtij kalendari."

3. Pas pikës 8.6 shtohen pikat 8.6/1 dhe 8.6/2 me përmbajtje si vijon:

" 8.6/1 Financon nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, realizimin e projekteve të cilat kanë karakter krijues e me objekt të veprimtarisë së tyre turizmin si dhe ngjarje që janë të përfshira në kalendarin turistik, pas miratimit të ministrit."

" 8.6/2 Monitoron zbatimin dhe realizimin e projekteve me karakter krijues të cilat kanë për qëllim promovimin e turizmit, si dhe të ngjarjeve që janë të përfshira në kalendarin turistik, të financuara nga fondi buxhetor i miratuar."

4. Pas pikës 8.12, shtohen pikat 8.12/1 dhe 8.12/2 me përmbajtje si vijon:

"8.12/1 Krijon të ardhura dytësore nga pagesat e subjekteve të cilëve u ofrohet shërbimi i promovimit të aktiviteteve të tyre në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit."

“ 8.12/2 Shërbimet e ofruara nga Agjencia Kombëtare e Turizimit, të cilat krijojnë të ardhura dytësore janë si më poshtë:

- a) Shërbim i promovimit të aktiviteteve dhe veprimtarive turistike të subjekteve private të interesuara si: hotele, bare, resorte, restorante, qendra tregtare, agroturizëm, qendra estetike, operatorë turistikë, agjenci udhëtimi, SPA, ATM, farmaci, dentist, spital, kompani eventesh etj, nëpërmjet aplikacioneve digjitale.
- b) Shërbim i promovimit të subjekteve të interesuara në hapësirat e panairëve kombëtare dhe ndërkombëtare ku Agjencia Kombëtare e Turizimit do të marrë pjesë.
- c) Shërbim në hapësirat e eventeve promovuese të Shqipërisë Turistike brenda dhe jashtë vendit si panairë apo evente të tjera promovuese të kalendareve turistike të aktiviteteve zbatimëse.
- d) Shërbim për promovim në evente, konferenca, seminare në fushën e turizimit në brenda dhe jashtë vendit, ku Agjencia Kombëtare e Turizimit do të promovojë Shqipërinë Turistike.
- e) Shërbim i promovimit të aktiviteteve në fushën e turizimit, të subjekteve të interesuara, në web-in e Agjencisë Kombëtare të Turizimit.”

5. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Turizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama